



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 2004/47

PËR GAZETËN ZYRTARE TË KOSOVËS

Dispozita të Përgjithshme
Neni 1

1.1. Gazeta Zyrtare e Kosovës është botim zyrtar i Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ), në të cilën do të botohen dokumentet zyrtare të IPVQ.

1.2. Titulli i Gazetës Zyrtare të Kosovës është “Gazeta Zyrtare e Kosovës.”

Përmbajtja
Neni 2

2.1. Në Gazetën Zyrtare të Kosovës do të botohen:

- a). Ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe të shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përhershëm;
- b). Rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Kosovës;
- c). Rregullativat dhe aktet tjera normative të Qeverisë dhe Ministrave;
- d). Marrëveshjet e karakterit ndërkombëtar;

2.2. Aktet juridike sipas nenit 2.1 të këtij ligji botohen në Gazetën Zyrtare me vendimin e organit, i cili e ka nxjerrë aktin e tillë.

2.3. Tekstet e akteve juridike të cekura në nenin 2.1 (a) deri (d) do të jenë po ashtu në dispozicion për publikun në formën elektronike. Këto materiale në formë elektronike do të jenë pa pagesë një muaj pas botimit të tyre në Gazetën Zyrtare.

Gjuha
Neni 3

3.1. Gazeta Zyrtare e Kosovës do të botohet në gjuhën shqipe, serbe, angleze, turke dhe boshnjake.

3.2. Në rast konflikti në mes versioneve të gjuhëve të ndryshme, gjuha origjinale në të cilën është shkruar dokumenti do të ketë përparësi.

Botimi
Neni 4

- 4.1. Gazeta Zyrtare do të botohet së paku një herë në muaj.
- 4.2. Botime të veçanta të Gazetës Zyrtare do të botohen sipas kërkesës.
- 4.3. Data dhe numri i Gazetës Zyrtare duhet të shënohen qartë në faqen e parë (frontepsis) të Gazetës Zyrtare.

Përgjegjësitë
Neni 5

- 5.1. Qeveria e Kosovës krijon Zyrën për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare të Kosovës.
- 5.2. Gazeta Zyrtare e Kosovës botohet nga furnizuesi i kualifikuar i zgjedhur në pajtim me rregullat për prokurorim të Kosovës.
- 5.3. Përgjegjësitë e Zyrës për Menaxhimin dhe Administrimin të Gazetës Zyrtare të Kosovës:
 - a). Zyra është përgjegjëse për hartimin e planit afatgjatë strategjik të punës dhe aktivitetëve të zyrës;
 - b). Zyra është përgjegjëse për grumbullimin e materialeve për botim;
 - c). Kontrollon teknikisht versionet finale të kompilacioneve model;
 - d). Mbikëqyr mbarëvajtjen e punës në mënyrë të vazhdueshme;
 - e). Mund të koordinojë punën me palët tjera me interes dhe donatorët e ndryshëm në bashkëpunim me Qeverinë;
 - f). Zyra për punën e vet i raporton Qeverisë së Kosovës.
- 5.4. Furnizuesi i kualifikuar do t'i përmbushë detyrimet e veta nën mbikëqyrjen e Zyrës për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare të Kosovës.

Çmimi dhe Shpërndarja e Gazetës Zyrtare
Neni 6

- 6.1. Me propozim të Zyrës për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare, Qeveria e Kosovës përcakton çmimin e Gazetës Zyrtare për shitje në treg.
- 6.2. Me propozim të Zyrës për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare, Qeveria e Kosovës vendos për subjektet përfituese dhe numrin e kopjeve të Gazetës Zyrtare që do të shpërndahen falas.
- 6.3. Shpërndarjen e kopjeve të gazetës Zyrtare e bën furnizuesi i kualifikuar.

Financimi
Neni 7

- 7.1. Financimi i Gazetës Zyrtare të Kosovës do të bëhet nga buxheti i konsoliduar i Kosovës.
- 7.2. Mjetet e realizuara nga shitja e Gazetës Zyrtare do të derdhen në buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Ankesat
Neni 8

- 8.1. Zyra për menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare pranon ankesat lidhur me gabimet dhe defektet që kanë të bëjnë me Gazetën Zyrtare.
- 8.2. Afatet dhe masat adekuate në lidhje me ankesat për Gazetën Zyrtare do të rregullohen me udhëzim të veçantë administrativ.

Zbatimi
Neni 9

- 9.1. Përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji është Qeveria e Kosovës nëpërmjet Zyrës për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare të Kosovës.
- 9.2. Me propozim të Zyrës për Menaxhim dhe Administrim të Gazetës Zyrtare, Qeveria e Kosovës nxjerr udhëzime administrative për zbatimin e këtij ligji.

Hyrja në Fuqi
Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe në ditën e shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Ligji Nr. 2004/47
27 Shtator 2004

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci